



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
PRIVREDNI SUD KOSOVA – COMMERCIAL COURT OF KOSOVO

AD/GJKK.nr.01/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Autoriteti Kompetent - Kryetari i Gjykatës Mahir Tutuli, duke vendosur sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga “P....C...” Sh.A., e paraqitur përmes të autorizuarit av. A.Sh., ndaj gjyqtarës të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë F.Zh.Y., bazuar në dispozitën e nenit 9, paragrafit 6, dhe nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 6 paragrafi 7, dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores Nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 20.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore e ushtruar nga “P....C...”, Sh.A., ndaj gjyqtarës së Gjykatës Komerciale – F.Zh.Y., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

1. Gjykata Komerciale e Kosovës, përkatësisht Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate (autoriteti), më 12.12.2022, përmes postës elektronike (email zyrtar) ka pranuar nga përfaqësuesi

i palës së paditur/kundërshtarit të masës siguroese, kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, kundër gjyqtarës së kësaj gjykate F.Zh.Y..

2. Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate, duke vepruar sipas shkresave të lëndës dhe kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore me aktvendimin e datë 06.01.2023 të evidentuar si AGjKK.nr.01/22, në kuptim të Nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe Nenit 6 paragrafit 5 të Rregullores Nr.05/2019 për procedurën disiplinore të Gjyqtarëve, ka suspenduar procedurën disiplinore për shkak se rasti është referuar në procedurë penale, me kallëzim penal dhe deri në marrjen e epilogut në procedurë penale procedura disiplinore nuk mund të zhvillohet.

3. Kryetari i gjykatës si autoritet kompetent përmes postës elektronike më 21.11.2023, është njoftuar nga gjyqtarja F.Zh.Y., me vendimin e Prokurorisë Themelore në Prizren për hudhjen e kallëzimit penal.

4. Sipas Prokurorisë Themelore në Prizren, me vendimin e datë 08.06.2023, i evidentuar si: PP/I.nr.88/23, hudhet kallëzimi penal privat nga i autorizuari i të dëmtuarës “P....C...”, Sh.A., ndaj të dyshuarës F.Zh.Y., sepse nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se e njëjta ka kryer vepra penale të përfshira në kallëzim penal, e as ndonjë veprë tjetër e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.

5. Duke u bazuar në të lartë shënuarat, autoriteti kompetent i kësaj gjykata, konform nenit 11 paragrafi 2, mbështetur në dispozitën e paragrafit 5 të nenit 9 dhe nenit 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka shqyrtuar ankesën e paraqitësit “P....C...” për iniciimin e procedurës Disiplinore, kundër gjyqtarës F.Zh.Y..

6. Paraqitësi i kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, në ankesën me shkrim pretendon se gjyqtarja F.Zh.Y., me rastin e vendosjes në çështjen juridike për caktimin e masës së sigurisë e evidentuar në Dhomat e Shkallës së Dytë si: Kom.Dh.shk.II.nr.817/22, nga paditësi/propozuesi “Anea” NTP, kundër të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit P....C..., ka bërë shkelje ligjore, marrje të vendimit të kundërligjshëm dhe njëanshmëri, duke e bazuar

vendimin për caktimin e masës së sigurimit bazuar në prova të papranueshme, pa asnjë referencë në të drejtën materiale, dhe në favor të propozuesit të masës siguroese i cili subjekt sipas pretendimeve është inekzistent/i shuar në regjistrat e biznesit. Provat e vetme të administruara nga gjykata për caktimin e masës së sigurisë janë një kopje e një plani në gjuhën anglezë që nuk ka fare të bëjë me lejen e ndërtimit të lëshuar nga Komuna e Prishtinës dhe disa fotografi të nxjerra nga propozuesi nga Google, pa vërtetuar fare autenticitetin e tyre, ashtu që nuk mund të përdoren si prova në procedurë gjyqësore ndërsa ka injoruar provat kyqe që gjenden në shkresat e lëndës përfshirë edhe Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë më të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit.

7. Ne parashtresë, inicuesi i kërkesës për procedurën disiplinore, e ka njoftuar Kryetarin e Gjykatës Komerciale se ndaj gjyqtarës F.Zh.Y. ka parashtuar Kallëzim penal në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, me datë 02.12.2022 dhe së bashku me parashtresën e ka dorëzuar edhe një kopje të Kallëzimit penal.

8. Autoriteti kompetent bazuar në nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka kërkuar nga anëtarja e kolegjit – gjyqtarja F.Zh.Y., deklaratë me shkrim lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore.

9. Në deklaratën me shkrim të datë 29.11.2023, gjyqtarja F.Zh.Y., ka thënë se: Aktvendimi me nr.K.Dh.Sh 817/22, për caktimin e masës së sigurimit është marrë në kolegjin e përberë prej tre (3) gjyqtarëve profesional në dhomën e shkallës së dytë me vota unanim, jo vetëm unë si kryetare e kolegjit, dhe se ky vendim ka një arsytim (shi arsytimin e aktvendimit). Pretendimet e palës ankuese janë deklarata të pabazuara, asnjëherë nuk do të ndikojnë që në rastet për të cilat unë si gjyqtare që marrë vendime, të më lëkundin nga parimet e Kodit të Etikës së Gjyqtarit dhe profesionalizmit time, gjithmonë në shërbim të ligjit dhe së drejtës. Andaj, konsideroj se pretendimet e palës ankuese janë të pabazuara në fakte dhe argumente dhe si të tilla janë të paqëndrueshme dhe tendencioze sepse pala ankuese me asnjë fakt të vetëm nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij por thjesht është bazuar vetëm në insinuata të tij personale të cilat nuk janë të

bazuara. Ndërsa sa i përket veprimeve në këtë çështje, kolegji ka vendosur në bazë të provave dhe në bazë të bindjes së lirë të gjyqtarit pa kurrfarë presioni apo ndikimi nga kushdo qoftë.

10. Kryetari i Gjykatës Komerciale, si autoritet kompetent për pranimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe vendosjen e tyre, pasi shqyrtoi kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me pretendimet si më lartë, deklaratën e gjyqtares F.Zh.Y., vendimin e prokurorit të shtetit për hudhjen e kallëzimit penal, si dhe shkresat e tjera të lëndës gjeti se kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore është e pabazuar. *“Autoriteti Kompetent sipas nenit 9 paragrafi 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 paragrafi 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore ose është parashkruar...”* – neni 9 paragrafi 6 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

11. Autoriteti i gjykatës vlerëson se në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, pretendimet e paraqitura, janë pretendime të natyrës së shkeljeve procedurale të cilat mund të atakohen në procedura gjyqësore, por të njëjtat nuk përbejnë shkelje disiplinore, të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

12. Rrjedhimisht, nuk mund të konstatohet se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore apo të ketë vendosur kundërligjshëm, njëanshëm apo me subjektivizëm, dhe nuk mund të konkludohet se gjyqtarja ka bërë shkelje gjatë trajtimit të rastit, andaj ankesa e paraqitur nuk përmban elementet e përcaktuara dhe informata bindëse se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore, të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

13. Bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, Autoriteti kompetent ka gjetur se kërkesa për iniciimin e

procedurës disiplinore, nuk mbështetet në fakte dhe prova mbi të cilat do të ngritet eventualisht dyshimi mbi shkelje të supozuar disiplinore, dhe si e tillë refuzohet si e pa bazuar.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

AD/GJJK.nr.01/2022

Datë 20.12.2023

Mahir Tutuli

Kryetar i Gjykatës Komerciale

Iu dërgohet:

- “P....C...” Sh.p.k – Parashtruesi i kërkesës
- Albert Zogaj – Kryesues i KGjK
- Avokati i Popullit
- F.Zh.Y. – Gjyqtare e Gjykatës Komerciale